



Shkruan: Dr. Shefqet Krasniqi

Kisha Ortodokse Serbe është e njohur për qëndrimet e saj të vrazhda. Asaj i faturohet një pjesë a madhe e fajit për krimet makabre të ushtrisë, policisë dhe forcave paramilitare serbe në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë.

Kisha është pikërisht vendi ku janë bekuar kriminelët. E, për çudinë e të gjithëve, Kisha, jo që nuk ka kërkuar falje kurrë, por ajo ka vazhduar me agjendën e saj djallëzore duke i kontribuar destabilizimit të rajonit. Ajo, është shfaqur si protagoniste e fuqishme edhe në bisedimet që janë zhvilluar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Vazhdimisht ka ushtrim ndikimi dhe presioni tek autoritetet serbe që të mos pranojnë asfarë marrëveshjeje me Kosovën, pasi që ajo është e tyre tërësisht. Kisha ende jeton me mite e përralla.

Kisha edhe tash, kur bisedimet janë në fazat më kritike, luajti një rol vendimtar. Mediet raportojnë se shkak i presionit të saj dhe disa shkaqeve tjera, Serbia refuzoi marrëveshjen. Misioni i saj më shumë është politik se fetar. Sikur nuk është ngopur me krimet e bëra, dhe se ende ka nevojë të pijë gjak të njerëzve të pafajshëm. Madje, ata këtë përpjekje të tyre janë të interesuar ta shndërrojnë edhe në projekt historik.

Vitin e kaluar, gjatë një vizite në Shkodër, Mitropoliti i Kishës Ortodokse Serbe në Mal të Zi, Amfillohije Radoviq, ka hapur një temë, e cila ka një lidhje paksa me këtë që është hapur këto ditë, ndryshimin e historisë. Ai thotë se shqiptarët nuk duhet t'i shohin serbët si pushtues, por si çlirimtarë. Nuk di nëse ky do të jetë epilogu i nismës së intelektualëve tanë, të cilët me çdo kusht po duan ta shpallin turkun si armik.

“Kemi ardhur për të vizituar varrezat e ushtarëve serbë të rënë gjatë Luftës Ballkanike, të cilët luftuan kundër pushtuesit osman. Këta ushtarë së bashku me të tjerë kanë sakrifikuar veten për çlirimin e Shqipërisë. Këtu në Bardhaj kanë rënë më se 10 mijë ushtarë serbë. Unë do doja të thosha edhe diçka tjetër, se ata kanë rënë në kohën kur Shqipëria shpalli Pavarësinë, në atë moment vendimtar historik për lirinë e vendit.” – kishte thënë ndër tjera Radoviqi.

Nuk më habit aspak ky qëndrim i Kishës.

Për keqardhje janë qëndrimet tona karshi deklaratave të tyre. Nuk e japin Kosovën pse konsiderojnë se fetarisht iu takon atyre. Kjo është arsyeja kryesore. Ata, edhe pse në emër të fesë kanë shkatërruar mbi dyqind xhami në Kosovë, nuk ndalen së kërkuari të drejtat e imagjinuara të tyre për Kosovën. Mjerisht, në anën e tyre ka dalë edhe Vatikani. Nuk e ka pranuar Kosovën, sepse ka vlerësuar se Kosova është djep i Kishës Ortodokse. E, në anën tjetër, autoritetet tona, lëre më që nuk janë kujtuar të diskutojnë çështjen e xhamive të shkatërruara gjatë luftës, por ata nuk janë ndalur së favorizuari Kishën Serbe në Kosovë, e cila, është e vetmja me letra që figuron në Kosovë.

Pushteti serb vazhdon me tërë fuqinë dhe autoritetin e tij që ta përkrah Kishën Ortodokse në Kosovë, përderisa pushteti ynë jo vetëm që injoron Bashkësinë Islame dhe nuk interesohet fare për xhamitë, por ai edhe i pengon muslimanët të ndërtojnë xhami. Të gjithë e dinë sa të zitë e ullirit e kemi hequr derisa e morëm një truall për një xhami të madhe në Prishtinë. Edhe kjo ka përgjegjësinë e vet.

Mund të tingëllojë paksa paradoksale, por sot kriminelët po trajtohen sikur të ishin viktimat!